

# RAPORT TEKNIK

*(Hartuar sipas Vendimit nr. 686 datë.29.07.2015)*

**IMPIANT I PERPUNIMIT TE SILICIT  
SUBJEKTI:"OMEGA METAL" sh.p.k.**

**Adresa: Lagjia 14, Shkozet, Durres**

**Tirane 2021**

## PËRMBAJTJA

➤ **Hyrje** \_\_\_\_\_ **3**

### **1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT** \_\_\_\_\_ **3**

- a) Qellimi i projektit te propozuar; \_\_\_\_\_ **3**
- b) Planimetria e vendodhjes se projektit, ku pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me kordinatat sipas sistemit Gaus Kruge, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise; \_\_\_\_\_ **3**
- c) Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e propozuar, si edhe percaktimin e njesise Vendore qe administron territorin ku propozohet projekti; \_\_\_\_\_ **14**
- ç) Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit; \_\_\_\_\_ **16**
- d) Informacion per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojten per hapje te rrugëve te reja; \_\_\_\_\_ **17**
- dh) Programin per ndertimin, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes, pas mbarimit te funksionimit te projektit; \_\_\_\_\_ **17**
- e) Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji); \_\_\_\_\_ **18**
- ë) Informacioni per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/ prane zones se projektit; \_\_\_\_\_ **18**
- f) Informacion per alternativat e marra ne konsiderate, per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret; \_\_\_\_\_ **18**
- g) Te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre; \_\_\_\_\_ **18**
- h) Te Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave etj; \_\_\_\_\_ **18**
- i) Informacion per lejet, autorizimet dhe licensat e nevojshme per projektin ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licensimin e projektit; \_\_\_\_\_ **18**
- j) Kopje te lejeve, autorizimeve dhe licensave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar; \_\_\_\_\_ **19**

➤ **HYRJE**

Shoqeria zhvilluese e aktivitetit "Impiant i perpunimit te silicit" eshte OMEGA METAL SHPK e cila eshte themeluar ne date 12.07.2021, dhe eshte regjistruar ne daten 13.07.2021, pra sic duket eshte nje komani e ri e cila ka pak muaj qe eshte themeluar dhe qe do te operoj ne treg ne fushen e perpunimit te metaleve (silicit). Nje nder objektivat e shoqerise OMEGA METAL eshte instalimi i impiantit te perpunimit te silicit, duke synuar keshtu qe te sjell nje zhvillim pozitiv ne kete fushe ne shqiperi. Projekti parashikohet te zhvillohet ne nje kapanon ne Lagjen 14, Shkozet, Durres, me siperfaqe 748 m<sup>2</sup> te marre me qira.

➤ **PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

a) **Qellimi i projektit te propozuar**

Projekti i propozuar synon ndertimin zhvillimin e aktivitetit per perpunimin e silicit me adrese ne Lagjen 14, Bashkia Durres, Qarku Durres. Bazuar ne ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" shtojca II, nga ana e AKM eshte klasifikuar si aktivitet qe i nenshtrohet procedures Paraprake te Ndikimit ne Mjedis dhe pajiset me Vendim per VNM Paraprake. Specifikisht klasifikohet ne Shtojcen II, **piken 4. Prodhimi dhe perpunimi i metaleve pika d) Instalime per trajtimin siperfaqesor te metaleve dhe materialeve plastike, duke perdorur nje proces elektrolitik ose kimik.**


Qellimi kryesor i ketij projekti eshte qe te plotesoj te gjitha kushtet per te cilen do te zhvillohet aktiviteti. Qellimi i hartimit te ketij raporti teknik eshte mbi vleresimin e pergjithshem, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve qe do te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis me qellim mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrushem te tij.

b) **Planimetria e vendodhjes se projektit, ku pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me kordinatat sipas sistemit Gaus Kruge, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise.**

Subjekti per realizimin e aktivitetit "Impiant i perpunimit te silicit.", eshte hartuar mbi bazen e principit te punes se aktivitetit te vene ne dispozicion nga investitori, shoqeria "Omega Metal" shpk. Territori ne kete studim pozicionohet ne qytetin te Durresit, ne nje zone me funksion kryesisht industrial, dhe te populluar ne menyre informale ne vitet e fundit.

Koncepti i aktivitetit bazohet ne parimet e studimit ku ben pjese. Synimi eshte qe te ruhen sa me shume parimet e percaktuara ne studim duke bere sa me harmonike marredheniet me kufitaret, duke shtuar siperfaqen e gjelberuar si dhe funksionet e zhvillimit te zones.

Projekti ne fjale do te ushtrohet ne Lagjen 14, ne zonën kadastrale **Nr. 8515**, Nr.pasurie **8/246-ND**, Shkozet, Durres.



**Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit GAUSS GRUGER**

Nr	Koordinatat ne Gauss Kruger	
	X	Y
1	4373275.06	4579135.72
2	4373294.46	4579146.92
3	4373312.35	4579115.01
4	4373292.17	4579103.82

**Tabela Nr. 2 Koordinatat e zones sipas sistemit KRGJSH**

Nr	Koordinatat ne KRGJSH	
	X	Y
1	456852.78	4578024.48
2	456872.04	4578035.9
3	456890.3	4578004.21
4	456870.25	4577992.78

- c) Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e propozuar, si edhe percaktimin e njesise Vendore qe administroin territorin ku propozohet projekti.

Vendi ku do te ushtrohet aktiviteti ndodhet ne Lagjen 14, Shkozet, Durres. Zona karakterizohet kryesisht nga objekte te tipologjise industriale magazina dhe objekte sherbimi.

Per percaktimin e vendosjes se ushtrimit te aktivitetit ne kete zone jane marr ne konsiderate::

- Distanca qe ka objekti me shtepite e banimit
- Infrastruktura e ngritur

Aktiviteti i ketij subjekti ben pjese ne Qarkun Durres, Bashkia Durres.



- c) Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.

Ne impiantin e ngritur, do te trajtohet si lende pare, silic i varfer, 40-55% i pa paster nga metalet shoqeruese Fe, Al, Ca, Na etj,

Ne te njejten kohe po ne kete impiant do te perdoret silic vendi nga vend burimi Kernaje me permbajtje te ulet te metaleve te sipërpermdur.

Nga materiali baze i importit dhe ai shqiptar, do te perfitohet product thellesisht i pastruar nga shoqeruesit metalore te me siperm (Silicon i pastruar) , qe perdoret ne industrine elektronike, ne industrine e prodhimit te aliazheve speciale si dhe ne mjekesi etj.

Produkti i fituar do destinohet per eksport te garantuar ,kryesisht ne Itali.

- I. Impianti eshte ngritur ne nje kapanon me sip. rreth 750 m<sup>2</sup>. Impianti eshte i paisur me dy vinca ure nje 10 ton, qe do perdoret per levizjen e materialit fillestar, per furnizimin e vaskave te perpunimit si dhe largimin perfundimtar te materialit te perpunuar.
- II. Po ashtu, ky vinc do te perdoret per perzierjen dhe homogjenizimin e produkteve perfundimtare atij, qe perfitohet nga materiali i importit, ne mase rreth 65% dhe atij qe perfitohet nga trajtimi i silic relativisht te paster te vendburimit tone Kernaje' ne mase rreth 35-40% me permbajtje metalesh relativisht me te ulet .
- III. Vinci tjetër 1 po perdoret per levizje te brendeshme te vaskave te neutralizimit gjate montimit , si dhe per levizjen e materialeve te ndryshem ne sasira me te vogla. Po ashtu, ky vinc do perdoret gjate levizjeve te materialit na sasiara me te vogla per pergatitjen me perfaqesi, te kampioneve perfaqesues per analizat fiziko kimike perkatesisht te lendeve te pare dhe produktit perfundimtar te homogjenizuar.
- IV. Ne impiant egziston paneli energjise elektrike.
- V. Egziston rrjeti i furnizimit me uje, si dhe kanalizimi i shkarkimit te solucioneve te neutralizuara mbas trajtimit te materialeve te siperpermendur, si dhe ujrart e larjes se materialit perfundimtar pas arritjes se parametrave te lejuar ne shkarkimet e solucioneve perfundimtare.

### Skema principiale teknologjike e perpunimit

Lenda e pare (silic 50-56%) shoqerohet me elemente metalore te padeshiruar Fe,Al,Ca,Mg,Na,K ,. etj.) Largimi ketyre elementeve, qe eshte qellimi kryesor, do realizohet ne impiantin e posacem te ngritur per kete qellim.


Materiali fillestar do te trajtohet me sol. HCl 1-2% ne vaskat antiacide.

Trajtim me HCl sol. 2 % ( 3- 5 ore ) kryhet deri ne neutralizimin e solucionit acid me pH 3.5 deri ne pH 6.5, gjate ketij veprimi do kryhet perzierje periodike per ekstraktim ne solucion sa me shume te ketyre metaleve.

Raporti i solucionit te acidit klorhidri me materialin do jete 1ton material/ 4-5000 l. sol. acid klorhidrik ,per te thelluar tretjen e metaleve shtothe ne fund dhe rreth 200 l sol .i holluar ac Nitrik 1 % . Me mbarimin e atakimit me solucione acide, gje qe vertetohet nga kalimi i solucionit ne vasken antiacide nga pH 3,5 deri ne mbi 6.5, qe tregon neutralizimin plotesisht te solucionit acid, duke krijuar kriperat perkatese neutrale me pH mbi 6.5 brenda normave te lejuara ne shkarkimet ujore.

Me qene se, permbajtja e metaleve ne solucionin e neutralizuar eshte ne sasira relativisht te larta, realizohet larja, hollimi i metejshem ne vazhdimesi i solucionit, me uje te bollshem rrjeti rreth 100-150 m<sup>3</sup>/ 1 ton material te perpunuar, deri ne arritjen e gjithë normave te lejuara ne shkarkimet e lengeshme. Behet fjale per permbajtjen e te ngurtave, joneve te metaleve te siperpermendura, konduktivitetit, salinitetit etj, persa i takon komponimeve organike bakteriale, ato nuk egzistojne ne solucionet e shkarkimit.

Skema teknologjike



Sic e kemi permendur materiali fillestar do te trajtohet ne vaska antiacide (Plastike) me solucion lares HCl 2% ne pH fillestar 3.5. Acidi klorhidrik do veproje me metalet e siper permendur duke i tretur ato dhe krijuar kripera perkatese neutrale sipas reaksioneve te me poshtem;




Sic e kemi shprehur keto kripra te tretura do shplahen ne nje vaske pastrami me uje te rjedhshem ose periodikisht po ne te njejtën vaske.

Sic shihet procesi eshte pa demshem, sepse nuk krijohen gaze te demshme si dhe solucionet hedhurine do jene ujrät neutrale me permbajtje minimale te kriprave te metaleve brenda normave te lejuara.

Sasia metaleve qe largohen me solucionet neutral do jete **rreth 50 % e permbajtjes ne lenden e pare**. Kjo do çojë në prodhimin e garantuar cilesor për eksport.

Skema e lidhjeve te paisjeve




- 1- Tubacion uji i paster (rrjeti)
- 2- Vaske plastike antiacide 5 m<sup>3</sup>
- 3- Tubacion shkarkimi i solucionit te neutralizuar ose i ujit te larjes perfundimtare.
- 4- Bidon plastic i acidit klorhidrik

**Paisjet e impintit të pastrimit dhe funksionimi i tyre:**

1. Vaskat plastike antiacide me volum 5000 litra.  
Cdo vaske do pranoje sasine prej 1 ton lende te pare, qe ze 20 % te volumit, pjesa tjeter do plotesohet me solucion acid HCl 2% solucioni acid ne vaske do perzihet periodikisht. Kinetika e neutralizimit do matet cdo ½ ore, deri ne neutralizimin nga pH 3.5-deri pH6.5.
2. Materiali. Mbas neutralizimit dhe ekstraktimit te metaleve kalohet ne vasken e dyte, ku do realizohet larja e plote me uje te fresket rrjeti, ky operacion mund te realizohet dhe ne te njejten vaske.
3. Levizja e materialit do behet priodikisht mbas mbarimit te plote te operacioneve, me ane te vincave ure mbi 1 ton. Materiali perpunuar do kaloje perseri ne thaset perkates 1ton (Bag) i gatshem per evadim. i njejti veprim do kryhet paralelisht dhe me trajtimin e silic te vendit vend burimit Kernaje qe do zere rreth 40 % te mases totale te produktit perfundimtar mbas perzierjes dhe homogjenizimit.
4. Per te bere kontrollin cilesor te produktit, nga cdo parti do merret kampion perfaqesues i produktit te gatshem dhe do perpunohet sipas skemes se pergatitjes se mostravet per analiza kimike.

**Skema e perpunimit per pergatitjen e mostres per Analizat Kimike, qe do kryhen ne Laboratorin e AKBN (Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore ) Tirane.**





5. Thyerja do realizohet ne thyes me nofulla 60 x 100 mm me N te instaluar 0.6 Kw



Thyes me nofulla

6. Bluarja do realizohet ne pulverizator me unaza me N te instaluar 2.5Kw



7. Vaskat do paisen me rubineta shkarkimi antiacide 1 polce
8. Acidi do mbahet ne bidona plastike. Nga ku do merret per pergitje te solucionit 2 % HCl.
9. Raporti i pergatitjes se solucionit acid 2% HCl do jete; 2 volume acid klorhidrik 37% me 34-35 Volume uje rrjeti. Pergatitja do realizohet nga drejtuesi teknik (kimist)
10. Uji i rrejtet do perdoret si per pergatitje te solucionit acide, po ashtu dhe per larje dhe hollim te solucionit te shkarkimit, ne kete rast do perdoren tuba plastike elastike antiacide 1 polce.
11. Energjia elektrike do merret nga paneli perkates (per thyrin,pulverizatorin, vincat dhe per ndricim. Fuqia N e instaluar do jete 16Kw.
12. Per mbrojtjen e rrezikut nga zjarri do perdoren shuarsa me shkume, vetem ne rast shkendijash elektrike, mbasi nuk ka rrezik tjetet (procesi eshte ne te lagur).

**Rritheksojme se gjate kryerjes se plote te procesit do largohen rreth 60% e metaleve (Fe,Al,Mg,Ca,Na,K. etj.) ,qe shoqerojne lenden e pare.**

### KARTA TEKNOLOGJIKE E PERPUNIMIT TE MALLIT

EMERTIMI	NJESIA	SASIA FILLESTARE	SASIA PAS PERPUNIMIT	METJA	VLERA LEK
Silic i varfer importi	ton	1	0.7	0.3	21,000
Silic vendi	ton	1	0.3	0.7	5,000
HCL	lit/ton	40	121	0.9	4,840
HNO <sub>3</sub>	lit/ton	5	242	0.9	1,210
Uje rrjeti	m <sup>3</sup> /ton	20	150	0.9	3,000
Energji elektrike	kw/ore/ton	25	14	0	350
Paga sigurime	lek/ton	1	6,300	0	6,300
Shpenzime tjera	lek/ton	1	300	0	300

Shpenzime operative	lek/ton	1	100	0	100
<b>SHUMA</b>	<b>lek/ton</b>				<b>42,100</b>

- Nga pasqyra e mesiperme rezulton se ne procesin e perpunimit te mineralit do te hyje nje sasi prej 1 ton "Silic i varfer" nga importi, dhe pas perpunimit te te tij do te perftohet nje sasi materjali prej 0.7 ton "Silic i paster" dhe 0.3 ton mbetje.

- **Nga te dhenat e mesiperme rezulton se koeficienti i shfrytezimit do te jete 70%.**

- Ne kete proces do te perpunohet edhe nje sasi prej 1 ton silic i kernajes, nga e cila do te mbetet 0.3 ton i paster. Kjo sasi do te perzihet me 0.7 ton silic i paster importi i perpunuar, nga e cila do te perftohet nje nje sasi prej 1 ton "Silic i paster SILIKON", sasi e cila eshte perfundimisht materjali i perftuar qe do te eksportohet.
- Materjalet e perftuara gjate procesit, siç jane 0.3 ton nga silic i varfer. 0.7 ton nga silic i kernajes, HCL, HNO<sub>3</sub>, Uje rrjeti, etj, do te konsiderohen "Mbetje te dala gjate perpunimit" dhe do te largohen nga ambjenti ne forme lengu nepermjet kanalizimeve.
- Mbetjet e larte permendura jane kripera te tretshme, dhe brenda normave te lejuara.

Lendet ndihmesie per kete veper jane:

-Energji elektrike qe sigurohet nga rrjeti elektrik i zones

-Uje qe do te sigurohet nga subjekti duke lidhur kontrate me ujesiellsin e zones

**Produkti perfundimtar i ketij aktiviteti do te jete silic i paster.**

- d) Informacion per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja.**

Pozicioni gjeografik, pershkrimi i rilievit, proceset fiziko-gjeologjike dhe gjeodinamike, ndertimi gjeologjik dhe hidrologjik, depozitimet, kushtet gjeologjike, karakteristikat fiziko-mekanike te shtresave gjeologjike per ushrimin e ketij aktiviteti lendet e para dhe produktet perfundimtare, te dhenat teknike per cdo proces te ketij aktiviteti, jane te pasqyruara me hollesi e te pershkruara ne detaje ne relacionet teknike pergatitur nga specialist te licensuar kontraktuar nga zhvilluesi i aktivitetit.

### **Furnizimi me energji**

Energjia elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues i zones, per te cilin subjekti ka lidhur kontrate me OSSHEE komform rregullave e ligjeve ne fuqi. Furnizimi ekzistues me energji elektrike i ketij territori eshte ai i Bashkise Dures.

## **Furnizimi me uje**

Uji teknologjik gjate proceseve te punes do te sigurohet nga vet subjekti pasi sic e kemi permendur aktiviteti qe do te zhvillohet e ka te gjitha imfrastrukturen e ngritur, komform te gjitha kushteve e rregullave ne fuqi duke lidhur nje kontrate te rregullt te furnizimit me uje me ujesjellsin e zones.

## **Shkarkimet e ujerave te ndotura**

Sic e kemi permendur edhe me siper ne kete lloj aktiviteti perdoret uje per pergatitjen e materialeve por ai dyzohet ne sasite e kerkuara dhe sasite e teperta te tij pra uje i perzier me kripera te metaleve do te shkarkohet ne kanalizimet e zones pasi kemi te bejme me uje te pasur me kripera te treteshme te cilat jane Brenda normave.

## **Grumbullimi i mbetjeve te ngurta, dhe ato urbane**

Do te caktohen vende te caktuara ne te cilat do te behet grumbullimi i mbetjeve te ngurta urbane. Ky grumbullim i mbetjeve do te behet cdo dite nga vet subjekti, dhe do te depozitohen ne vendet e caktuara nga Pushteti Vendor per te cilen subjekti do te jete dhe nje taksapagues i rregullt.

## **Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja**

Infrastruktura është ekzistuese kështu që nuk është e nevojshme ndertimi apo hapja e rrugëve të reja.

**dh) Programin per ndertimin, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te prjektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te sipërfaqes, pas mbarimit te funksionimit te projektit.**

Ne kete aktivitet nuk do te kete punime ndertimore, pasi ky eshte nje aktivitet perpunues. Ndikimet ne peisazh nuk do te kete pasi aktiviteti zhvillohet ne ambjent te mbyllur brenda godines (kapanon) te marre me qira nga zhvilluesi i aktivitetit (kontrata e qirase bashkengjitur). Nuk shkarkohen elemente te demshem per mjedisin, si ne ate ujqor, ne ajer, toke dhe ne diversitet. Ne perfundim te aktivitetit dhe pse mendohet qe ky aktivitet do te vazhdoje te ekzistojte per aq kohe sa ne treg do te kete kerkese per keto material qe do te perpunohen. Shoqeria do te kryej edhe rehabilitimin e hapsires perreth dhe ku eshte e mundur do te bej dhe gjelberimin e saj. Mbjellja e pemeve dhe sistemimi i ambjenteve ndihmon ndjeshem ne eliminimin e demtimeve dhe rehabilitimin e peisazhit. Me perfundimin e aktivitetit do te largohen te gjitha makinerite dhe paisjen dhe godina mund te perdoret per nje tjetër funksion ne fushen e shërbimeve.

- e) **Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji).**

**Lendet e para** qe do te perdoren do te jene kryesisht silic i varfer 40-55% i pa paster nga metalet shoqeruese Fe, Al, Ca, Na, etj.

**Lende te para ndihmese** energji elektrike nga rrjeti per ndricim dhe per venien ne pune te paisjevedhe sipas rastit dhe nevojës qe do te kete ne objekt edhe per sherbime te tjera. Uje per proceset e perpunimit dhe per nyjen higjeno-sanitare.

- ë) **Informacioni per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/ prane zones se projektit.**

Funksionimi i ketij aktiviteti do te sjelli bashkpunimin e punes se subjektit me institucionet pergjegjese te OSHEE, Ujesjelles-Kanalizimeve, per te ber te mundur lidhjen e energjise elektrike, ujit, si dhe lidhjen per shkarkimin e ujerave te procesit te punes dhe ujerave te ndotur sanitare.

- f) **Informacion per alternativat e marra ne konsiderate, per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret.**

Perzgjedhja e vendodhjes se projektit ne fjale ka ardhur si pasoje e vendodhjes se tij, aksesit qe ka me rruget lidhese distancat e konsiderueshme me zonat e medha te banuara duke qene se aktiviteti qe do te zhvillohet konsiston ne perpunimin e silicit, dhe subjekti zhvillues do te jete OMEGA METAL SHPK.

- g) **Te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre.**

Gjate ushtrimit te aktivitetit lendet e para te cilat do te perdoren eshte silic i varfer 40-55 % i papaster nga metalet shoqeruese si Fe, Al, Ca, Na etj. dhe lendet ndihmese do te jene uji, energji elektrike, si dhe produkte te konsumit te perditshem.

Energjia elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues i zones duke lidhur nje kontrate me OSHEE, uje do te sigurohet nga vet subjekti duke lidhur kontrate ujesjellesin e zones.

Po keshtu dhe shkarkimet do te behen ne sistemin e kanalizimeve te zones.

**h) Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave etj.**

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti nuk nevoiten ndertime per kampe apo rezidenca per punetoret pasi nuk do te jete nevoja sepse punetoret do te merren nga zonat ne afersi te vendit ku do te ushtrohet aktiviteti dhe puna do te jete vetem 8 ore ne dite, cka nenkupton qe nuk do te jete nevoja per ndertimin e kampeve apo te rezidencave per punonjesit.

**i) Informacion per lejet, autorizimet dhe licensat e nevojshme per projektin ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licensimin e projektit.**

Ne baze te Vendimit Nr.686, date 29.07.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjithesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore" subjekti OMEGA METAL ka pergatitur dokumentat per tu paisur me VENDIM Mjedisor (VNM Paraprake) si ne rastin tone.

**j) Kopje te lejeve, autorizimeve dhe licensave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar.**

Subjekti ne kete faze qe ndodhet nuk disponon asnje leje, autorizim apo license per ushtimin e aktivitetit ne fjale.

*Hartoi raportin teknik  
TAULANT SHPK*